LIGJ
Nr. 8588, datë 15.3.2000

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS SË LARTË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 6, 81 pika 2 shkronja "a" dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

KREU I
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I GJYKATËS SË LARTË

Neni 1
Përbërja e Gjykatës së Lartë

Gjykata e Lartë përbëhet nga 17 gjyqtarë.

Neni 2
Selia e Gjykatës së Lartë

Gjykata e Lartë e ka selinë në Tiranë.

Neni 3
Kushtet për t'u emëruar gjyqtar i Gjykatës së Lartë

Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga radhët e gjyqtarëve me vjetërsi jo më pak se 10 vjet ose nga radhët e juristëve të shquar, që e kanë ushtruar këtë profesion jo më pak se 15 vjet.

Neni 4
Procedura e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë

Gjyqtari i Gjykatës së Lartë emërohet nga Presidenti i Republikës, pasi është marrë më parë pëlqimi i Kuvendit.

Neni 5

Mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë fillon me hyrjen në fuqi të dekretit të Presidentit për emërimin e tij.
Mandati i Kryetarit të Gjykatës së Lartë llogaritet brenda mandatit të gjyqtarit të kësaj gjykate.

Neni 6
Mbarimi i parakohshëm i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë

Në rastet e parashikuara në nenin 139 të Kushtetutës, Kryetari i Gjykatës së Lartë ose çdo gjyqtar i saj, i propozon Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të deklarojë me vendim mbarimin e mandatit të gjyqtarit të kësaj gjykate.

Neni 7
Kryetari i Gjykatës së Lartë

Gjykata e Lartë përfaqësohet nga Kryetari.
Kryetari i Gjykatës së Lartë kryen këto detyra:
a) Drejton Kolegjet e Bashkuara.
b) Bën ndarjen e gjyqtarëve në kolegje.
c) Kujdeset për funksionimin normal të Gjykatës së Lartë.
ç) Emëron dhe shkarkon ndihmësit ligjorë.
d) Emëron dhe shkarkon personelin e shërbimeve ndihmëse.
dh) Bën kërkesat për buxhetin vjetor të Gjykatës së Lartë dhe mbikëqyr zbatimin e tij.
e) Miraton strukturën, organikën dhe rregullat e brendshme të Gjykatës së Lartë.
Kryetari i Gjykatës së Lartë kryen edhe detyra të tjera që parashikohen me ligj.
Kryetari i Gjykatës së Lartë në ushtrimin e funksioneve të tij ndihmohet nga këshilltarët dhe personeli ndihmës.

Neni 8
Zëvendësimi i Kryetarit

Në rastet kur Kryetari nuk mund të kryejë detyrat e tij, zëvendësohet nga Kryetari i Kolegjit Civil në kryerjen e detyrave që parashikohen në shkronjat "a", "c" dhe "dh" të nenit 7 të këtij ligji.

Neni 9
Këshillimi me gjyqtarët

Kryetari i Gjykatës së Lartë këshillohet me gjyqtarët, sidomos për:
a) strukturën e Gjykatës së Lartë;
b) rregullat e brendshme të funksionimit të Gjykatës së Lartë;
c) kërkesat për buxhetin e Gjykatës së Lartë;
ç) ndarjen dhe lëvizjen e gjyqtarëve në kolegje.

Neni 10
Kolegjet

Gjykata e Lartë organizohet në Kolegjin Civil dhe Kolegjin Penal.
Çështjet penale ushtarake gjykohen nga Kolegji Penal, ndërsa çështjet me karakter tregtar, administrativ, familjar, të punës etj. gjykohen nga Kolegji Civil.
Kryetari i Gjykatës së Lartë, pasi merr mendimin e gjyqtarëve, mund t'i lëvizë ata nga një kolegj në tjetrin, për arsye të ngarkesës së punës dhe të funksionimit normal të gjykatës.

Neni 11
Kryetari i kolegjit

Kryetari i kolegjit zgjidhet nga anëtarët e tij me shumicë votash për një periudhë njëvjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 12
Kompetencat e kolegjeve

Kolegjet e Gjykatës së Lartë gjykojnë ankimet për çështje gjyqësore sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe në Kodin e Procedurës Penale.

Neni 13
Trupi gjykues

Kolegjet e Gjykatës së Lartë gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë.

Kur trupi gjykues nuk mund të formohet nga gjyqtarët e një kolegji, ai plotësohet me gjyqtarë të kolegjit tjetër. Këta gjyqtarë caktohen me short.

Kur në gjykim merr pjesë Kryetari i Gjykatës së Lartë, ai kryeson trupin gjykues. Në të gjitha rastet e tjera trupin gjykues e kryeson kryetari i kolegjit përkatës dhe, në mungesë të tij, gjyqtari më i vjetër.

Neni 14

Çështjet që gjykohen në Kolegjet e Bashkuara

Gjykata e Lartë gjykon në Kolegjet e Bashkuara:

a) rastet e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin e Procedurës Penale;

b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;

c) kërkesat për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore;

ç) raste të tjera, të parashikuara me ligj.

Neni 15

Gjykimi në Kolegjet e Bashkuara

Kur Gjykata e Lartë gjykon në Kolegje të Bashkuara, seanca kryesohet nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.

Në mungesë të tij seancën e kryeson Kryetari i Kolegjit Civil.

Kur Gjykata e Lartë gjykon në Kolegje të Bashkuara, caktohen me short 2 relatorë, të cilët, në mënyrë të pavarur, përgatisin relacionet dhe i paraqesin ato në gjykim.

Neni 16

Kuorumi

Kolegjet e Bashkuara gjykojnë kur në to marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

Vendimi merret me shumicën e votave të gjyqtarëve që marrin pjesë në gjykim.

Neni 17

Njësimi ose ndryshimi i praktikës gjyqësore

Njësimi ose ndryshimi i praktikës gjyqësore bëhet nga Kolegjet e Bashkuara kur:

a) kërkohet nga secili kolegj i Gjykatës së Lartë;

b) kërkohet nga Kryetari i Gjykatës së Lartë;

c) Kolegjet e Bashkuara e çmojnë të nevojshme një gjë të tillë.

Neni 18

Gjykimi gjatë kohës së pushimeve vjetore

Gjatë kohës së pushimeve vjetore, një numër i nevojshëm gjyqtarësh caktohen me short për të gjykuar çështjet që, sipas ligjit, vlerësohen të ngutshme.

Neni 19

Vendimet dhe botimi i tyre

Vendimet e Gjykatës së Lartë shpallen të arsyetuara jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i shqyrtimit gjyqësor.

Vendimet e kolegjeve të Gjykatës së Lartë, së bashku me mendimet e pakicës, botohen në Buletinin Periodik të Gjykatës së Lartë.

Vendimet për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.

Neni 20
Ndihmësit ligjorë

Gjyqtari i Gjykatës së Lartë ka deri në dy ndihmës ligjorë dhe personin e shërbimit.

Ndihmësit ligjorë përzgjidhen nga vetë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë ndërmjet juristëve që plotësojnë kushtet ligjore për t'u emëruar gjyqtarë të gjykatës së shkallës së parë ose të gjykatës së apelit. Ata emërohen nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.

Ndihmësit ligjorë përfitojnë përkatësisht pagën e gjyqtarit të shkallës së parë ose të gjykatës së apelit.

Ndihmësi ligjor largohet nga detyra me urdhër të Kryetarit të Gjykatës së lartë, me propozimin e gjyqtarit përkatës.

Kur largimi nga detyra është bërë pa arsye të përligjura, ai ka të drejtën vetëm të shpërblimit të dëmit deri në shumën e pagës vjetore.

Neni 21
Detyrat e ndihmësit ligjor

Ndihmësit ligjorë studiojnë ankimet, dosjet gjyqësore, përgatisin relacionet për çështjet që janë në gjykim duke dhënë mendimin e tyre, u përgjigjen ankesave, përgatisin materialet e nevojshme, si dhe kryejnë çdo detyrë tjetër që u ngarkohet nga gjyqtari i Gjykatës së Lartë.

KREU II
STATUSI I GJYQTARIT TË GJYKATËS SË LARTË

Neni 22

Paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë është e barabartë me pagën e ministrit, ndërsa ajo e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, 20 për qind më e lartë se paga e gjyqtarit të kësaj gjykate.

Neni 23

Gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe bashkëshortes (bashkëshortit) të tij/saj u njihet e drejta e pajisjes me pasaportë diplomatike edhe për tre vjet pas mbarimit të mandatit.

Neni 24

Trajtimi protokollar dhe shëndetësor i anëtarëve të Gjykatës së Lartë, është i njëjtë me atë të deputetit.

Neni 25

Me plotësimin e mandatit, sipas kushteve të parashikuara në nenin 136 pika 3 të Kushtetutës, gjyqtari i Gjykatës së Lartë, me kërkesën e tij, emërohet gjyqtar në gjykatën e apelit.

KREU III
ADMINISTRIMI I SHËRBIMEVE TË GJYKATËS SË LARTË

Neni 26
Kancelari i Gjykatës së Lartë

Kancelari drejton shërbimet ndihmëse në Gjykatën e Lartë.

Kancelar emërohet një jurist, i cili e ka ushtruar profesionin e juristit për një periudhë jo më pak se 7 vjet.

Kancelari emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.

Neni 27
Administrimi i shërbimeve

Kancelari organizon shortin gjyqësor.

Kancelari i propozon Kryetarit të Gjykatës së Lartë emërimin dhe shkarkimin e personelit të shërbimeve ndihmëse të Gjykatës së Lartë.

Neni 28
Shërbimet ndihmëse të Gjykatës së Lartë

Shërbimet ndihmëse në Gjykatën e Lartë kryhen nga sekretaria gjyqësore, sektori i administratës, i financës, i informatizimit, i regjistrimit, i ruajtjes së dokumenteve, i ruajtjes së rendit të brendshëm, i studimeve e marrëdhënieve me jashtë dhe biblioteka.

Për shërbime të tjera ndihmëse, Kryetari i Gjykatës së Lartë, me propozimin e Kancelarit, mund të krijojë sektorë të tjerë.

Neni 29
Garantimi i rendit dhe i sigurisë

Për të garantuar rendin dhe sigurinë, pranë Gjykatës së Lartë vepron, sipas urdhërave të Kryetarit të kësaj Gjykate, shërbimi i vazhdueshëm i policisë.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 30

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e dispozitave të këtij ligji në lidhje me të drejtat financiare dhe protokollare të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Neni 31

Ligji nr.8362, datë 1.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Kasacionit”, si dhe çdo dispozitë që bie ndesh me këtë ligj, shfuqizohen.

Për të gjitha problemet e tjera që nuk gjejnë zgjidhje në këtë ligj, zbatohen dispozitat e ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 32

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2589, datë 3.4.2000, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.